



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
"KODRA BAILIFF SERVICE" SH.P.K.

LN-6925-10-2013

NIPT L32221069N

Adresa: Rr. "Frederik Shiroka", Kulla.3, Shk.3 Kati 2, Nr. 4, Tirane
Web: www.kodrabailiff.com

Tel/Fax +355 (0) 42200056 Cel +355 (0) 690381888
E-mail: info@kodrabailiff.com

Nr. 1799/14 0815-16 . Prot

Tiranë më 29/09/16

URDHËR
"PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"

Drejtuar: Qendra Kombëtare e Biznesit
Adresa: Tiranë

Per dijeni: Debitorit : Shoqëria "Tegola Edil Centro" sh.p.k.

Nipt K32231003S

Adresa: Rruga "Vangjel Noti", Laprake, Tirane

Kreditor : Shoqëria "Fit-Mek Oil" sh.a.

Nipt K62303017P

Adresa: Rruga "Abdyl Frasherri", Pallati "Hekla", Kati i 8-te, Apartamenti 31, Tirane

Pranë Shoqërisë "Kodra Bailiff Service" sh.p.k. me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbareme me numër 0815-16 regj dhe me palë:

Kreditor : Shoqëria "Fit-Mek Oil" sh.a. Nipt K62303017P

Debitorit : Shoqëria "Tegola Edil Centro" sh.p.k. Nipt K32231003S

Objekti : Likuidim Fature

KONSTATOVA:

Për titullin ekzekutiv "Fatura tatimore te shitjes nr. 70 date 16.07.2015; nr. 73 date 17.07.2015; nr. 25 date 29.07.2015; nr. 21 date 18.08.2015; nr. 09 date 03.07.2015 dhe nr.46 date 01.08.2015" është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit Vendimi Nr. 5076 Akti datë 28/07/2016 i Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe është vendosur "... Lëshimi i urdhrimit të ekzekutimit per Fatura tatimore te shitjes nr. 70 date 16.07.2015; nr. 73 date 17.07.2015; nr. 25 date 29.07.2015; nr. 21 date 18.08.2015; nr. 09 date 03.07.2015 dhe nr.46 date 01.08.2015".

Me vendim të përmbaruesit gjyqësor privat, mbështetur dhe në nenin 519 të K. Pr. Civile është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, rrjedhimisht për ekzekutimin e tij, duhet te kryhet verifikimi dhe vendosja masës së sekuestros në QKB, mbi aktivin që zotëron pala debitore.

Për këtë arsye në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

URDHËROJ:

1. Vendosjes e masës së sekuestros konservative në aksionet, kuotat e subjektit **Shoqëria "Tegola Edil Centro" sh.p.k. Nipt K32231003S**, me si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimin e këtyre aksioneve/kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrimit tregtar. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë.
2. Vendosjen e masës së sekuestros konservative në të tjera aksione/kuota të cilat zotërohen nga pala debitore **Shoqëria "Tegola Edil Centro" sh.p.k. Nipt K32231003S** në shoqëritë e tjera të regjistruara pranë regjistrimit tregtar.
3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
4. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenet 606 e vijues të K. Pr. Civile, si dhe në rast se ka vend do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
5. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor te vendit te ekzekutimit brenda 5 ditëve nga marrja dijani.

"Kodra Bailiff Service" sh.p.k
PËRMBARUESI GJYQËSOR
Eris SOTIRI

